



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:016/01-25329, datë: 29 Prill 2026.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2.pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.Qershor 2008), të nenit 90, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.22, datë: 19. Tetor 2011), të nenit 12, paragrafi 1.6 i Rregullores (QRK) - Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenit 20.paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër: 01-016/01-413431, datë: 30.Shtator 2020, ne propozim te kryetarit te Komunës, Kuvendi i Komunës së Pejës, në takimin e mbajtur me datë: 29 Prill 2026, merr këtë:

VENDIM
Nr.23/2026

Mbi miratimin e raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera, për periudhën, janar 2025 - shkurt 2026, në Komunën e Pejës

1. MIRATOHET Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për periudhën, janar 2025 - shkurt 2026, në Komunën e Pejës.
2. Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për periudhën, janar 2025 - shkurt 2026, në Komunën e Pejës, është punuar nga Komisioni Lokal për Vlersimin e Dëmëve shkaktuara në të mira materiale dhe nga ndikimi i fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Pejës me Vendim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nr. 112/02-121892/2022. dt. 23.11.2022.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, për periudhën, janar 2025 - shkurt 2026.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Pejës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

Vendimi ti dërgohet:

MAPL.

Kryetarit të Komunës.

Komisionit Qendror për Vlersimin e Dëmëve të shkaktuara në të mira materiale dhe nga ndikimi i i fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.

MPB – AME.

DMSH dhe Arkivë.